

## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,08.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.06.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Atomed", për aktivitetin: **"Furnizimi emergjent me teste serologjike-Sars Coc-2"** dhe me Nr. të Prok: 616 21 3071 111 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Atomed" e datës 04.06.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi emergjent me teste serologjike Sars Cov-2" me **Nr. të Prok: 616 21 3071 11 kundër Njoftimit për Kontrate të Autoritetit Kontraktues**, të datës 25.05.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 01.06.2021
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Atomed" me datë 04.06.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi emergjent me teste serologjike sars Cov-2".

Autoriteti Kontraktues, me datë 08.06.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pergjigjet ne pretendimet tuaja i kemi percjellur edhe ne shkresen e dates 31.05.2021 sipas kerkeses tuaj per sqarime,por ne baze te kerkeses tuaj i perserisim edhe kete here:

**-Kerkesat tona jane te bazuara ne gjendjen ekzistuese te krijuar nga situata emergjente e pandemise sipas te ciles Autoriteti Kontraktues ka siguruar aparaturat qe I kemi cekur ne sqarime dhe te njejtat duhet ti shfrytezoj pasi qe nuk ka kapacitete te mjaftueshme per angazhim te aparaturave te reja dhe se ato ekzistuese jane ne gjendje funksionale.**

Pra kerkesa per prezentimin e ketyre dokumentave te kerkuara ne oferte deshmon se produktet duhet te jene origjinale dhe kompatible dhe kerkesa e juaj per largimin e ketyre dokumenteve eshte e pabazuar.

Kerkesa eshte bere per blerjen e ketyre testeve per aparatin VIDAS dhe CHORUS .Mund te pranohet edhe autorizimi nga distributor (apo autorizimi I prodhuesit per dilerin).Kjo eshte bere me qellim qe testet te jene origjinale ,te sakta dhe te sigurta nga prodhuesi ose dileri I autorizuar,per aparatet qe posedon QKMF-Prishtine(Mini- VIDAS,VIDAS -PC dhe tri aparateCHORUS


Pra te gjitha kerkesat jane ne harmoni me paisjet ekzistuese,por eshte dhene mundesia qe te konkuroj edhe ndonje OE-ik tjeter me aparatura kompatible.

**Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.**

**Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.**

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit